

RECENSION

U1 - Filozofia Filologjike - Regjistrimi dhe Vlerësimi
U7 - Fakulteti Filologjik - Përkthimi dhe Mësimi
Nr. Ep. 18-32/1
05.02.2024 vititrog
Tetovë - Tetovë

PËR VLERËSIMIN E TE TËZËS SË DOKTORATURËS TË KANDIDATES,
Z.NJ. JETMIRE ALIU

NË PROGRAMIN STUDIMOR GJUHË DHE LETËRSI GJERMANE TË
FAKULTETIT FILOLOGJIK, UNIVERSITETI I TETOVËS

Deri te:
KËSHILLI MËSIMOR-SHKENCOR I FAKULTETIT FILOLOGJIK

Në bazë të vendimit të Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Filologjik, në mbështetje të nenit 62 të Rregullores për kushtet, kriteret dhe rregullat e regjistrimit dhe studimit në ciklin e tretë të studimeve – studimet e doktoraturës në Universitetin e Tetovës, në mbledhjen e Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Filologjik, të mbajtur më datë 20.12.2023, me nr. 18-935/3, të protokolluar në Arkivin e Fakultetit Filologjik më datë 21.12.2023, është sjellë vendim për formimin e komisionit vlerësues të tezës së doktoraturës së kandidates znj. Jetmire Aliu në programin studimor: Gjuhë dhe letërsi gjermane, në përbërje:

1. Prof. Dr. Berton Sulejmani – kryetar
2. Prof. Dr. Ajtene Hajdari-Qamili – anëtar
3. Prof. Dr. Arbër Çeliku - anëtar
4. Prof. Dr. Gjuliano Isecini - anëtar
5. Prof. Dr. Shadan Ramadani – anëtar

Komisioni vlerësues, duke qenë falënderues për besimin e dhënë, ka nderin të paraqesë këtë:

R A P O R T

për vlerësimin e tezës së doktoraturës së kandidatës Jetmire Aliu me temë:
Prejardhja e gjuhës shqipe në këndvështrimin e studiuesve gjermanë

Të dhëna biografike dhe arsimimi:

Kandidatja Jetmire Aliu është me prejardhje nga Kërçova.

Shkollimin fillor dhe të mesëm i ka kryer në Kërçovë.

Studimet në fushën e gjuhës dhe letërsisë shqipe (Albanologji) i ka kryer në Universitetin "Shën Kirili dhe Metodi" - Shkup në vitin 2010, me rezultate të shkëlqyera, ku dhe i ka kryer studimet pasdiplomike (magjistraturën) në vitin 2013.

Nga viti 2011 është profesoreshë e gjuhës shqipe në gjimnazin "Zef Lush Marku" në Shkup.

Nga viti 2013 deri në vitin 2017 ka qenë e angazhuar edhe si lektore për gjuhë shqipe në Universitetin e Tetovës.

Me hapjen e studimeve të doktoraturës për herë të parë në Universitetin e Tetovës në vitin akademik 2015/16 ajo, duke marrë parasysh interesin dhe dëshirën e zjarrtë për thellimin e njohurive të saj në fushën e etimologjisë së gjuhës shqipe, regjistrohet në studimet e doktoraturës në programin studimor Gjuhë dhe letërsi gjermane, i vetmi program i akredituar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës së RM-së, sot RMV dhe, në konsultim me mentorin e akredituar, Prof. Dr. Arbër Çeliku, përzgjedh temën sa aktuale aq edhe sfiduese: *Prejardhja e gjuhës shqipe në këndvështrimin e studiuesve gjermanë*.

Gjatë dy semestrave të parë ajo i ka dhënë me sukses të gjitha provimet, e para me Rregulloren dhe Programin e akredituar të shkollës dokto­rale me sukses të shkëlqyeshëm.

Po ashtu me sukses i ka përmbyllur të tria konferencat dokto­rale, të parapara me Rregulloren e studimeve të doktoraturës.

Ka publikuar këto punime shkencore ndërkombëtare:

- *Një tipologji e ndryshimit kuptimor të fjalëve dhe lindja e implikaturave të reja gjuhësore gjatë pandemisë COVID 19*, botuar në revistën «Filologjia», organ i Fakultetit Filologjik të Universitetit të Tetovës, Nr. 8 (13-14). Fq. 9-14 (shih dhe linkun [Items where Author is "ALIU, Jetmire" - Universiteti i Tetoves \(unite.edu.mk\)](#))

Boshti tematik i këtij punimi është dinamizmi gjuhësor, i cili me shpërthimin e pandemisë të njohur si Sars COVID 19 e përshpejtoi edhe më shumë atë. Me këtë rast, u trajtuan fjalët e reja që hynë në diskursin publik dhe komunikim e gjerë, sidomos prurjet e reja nga anglishta si: piku (për kulminacionin), koronavirusi (kompozitë kjo që në shqipe duhej të ishte Virusi Korona), distancë sociale (në vend të «largësi fizike»), duke i kategorizuar të gjitha këto shprehje edhe në shkallën e metaforizimeve si «lufta», «armiku i padukshëm», «bomba», «u krimbëm», etj.

- *A typology of semantic change of words and the raise of new linguistic frames during COVID 19 pandemic.*

Ky punim fillimisht është prezantuar në konferencën vjetore shkencore të Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT) në Republikën e Kosovës, të mbajtur në nëntor 2020 dhe më pas është botuar në revistën ndërkombëtare në këtij Universiteti në gjuhën angleze në vitin 2021. (shih dhe linkun [UBT Knowledge Center - UBT International Conference: A typology of semantic change of words and the raise of new linguistic frames during COVID 19 pandemic \(ubt-uni.net\)](#))

- *The realisation of Text Coherence Through Personal Pronouns in Albanian, English and German Language.*

Ky punim është botuar në dhjetor të vitit 2021 në revistën ndërkombëtare me seli në Londër «Recistë për letërsi, gjuhë dhe linguistikë» të rrjetit shkencor Platforma Ndërkombëtare për Shpërndarjen e Dijes (iiste), i njohur tashmë për botime serioze me indeks ndërkombëtar dhe faktor të impaktit, Vëll. 84, 2021, fq. 1-5 (shih dhe linkun [The Realization of Text Coherence Through Personal Pronouns in Albanian, English, and German language | ALIU | Journal of Literature, Languages and Linguistics \(iiste.org\)](#))

Boshtin tematik të këtij punimi e përbëjnë përemrat e shqipes, si mjet i realizimit të koherencës tekstore, krahasuar me gjuhën angleze dhe atë gjermane, në të cilat përemri nuk është mjet i koherencës, por i kohezionit. Në këtë punim sqarohet se përdorimi i përemrave përbën një veçanti, sepse gjuha shqipe nuk i realizon ata në sipërfaqe të tekstit por janë në mendje, gjë që nuk ndodhet me të dyja gjuhët e lartpërmendura. Sidomos është paraqitur edhe roli i trajtave të shkurtra të përemrave, që luajnë rolin e kryefjalës dhe të kundrinorëve, kurse gjuhët gjermanike (anglishtja dhe gjermanishtja) ato fare nuk i kanë.

Vlerësimi i tezës së doktoraturës së kandidatës, znj. Jetmire Aliu

Teza e doktoraturës e kandidatës, znj. Jetmire Aliu i plotëson si kushtet formale-juridike në bazë të Rregullores së studimeve të doktoraturës të Fakultetit Filologjik të Universitetit të Tetovës, po ashtu edhe ato përmbajtësore. Ajo është e shkruar në 131 faqe, me një rrjedhshmëri gjuhësore dhe stilistikore në nivelin e duhur, strukturimi i krerëve është i qartë dhe zhvillohet në dy linja: teorike dhe empirike, kurse burimet janë në numër të madh dhe dëshmojnë për autencitetin e hulumtimit në fjalë, që nënkupton se kandidata ka dëshmuar për një pjekuri hulumtuese-shkencore. Po ashtu, punimi nuk përmban elemente të plagjiaturës, verifikuar edhe në sistemin për plagjiaturë të MASH-it të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Tematika në fjalë është e një rëndësie të veçanti, sidomos për korpusin shkencor mbarëbotëror mbi etnogjenezën e gjuhës shqipe, e cila ka hapur qysh në kohët më të hershme në gjuhësinë botërore një debat të veçantë, por edhe politike, duke pasur parasysh rrethanat politike-historike të popullit shqiptar, si popull i pushtuar dhe shtypur gjatë historisë.

Kandidata ia ka dalë me sukses ta shtjellojë kronologjinë e lindjes së shkrimit shqip, sidomos të hartojë një portal shkencor mbi studiuesit gjermanë, të cilët janë themelvënësit e gjuhës shqipe karshi studiuesve sllavë e grekë, të cilët nuk kanë reshtur së punuar, që gjuha shqipe të zhbëhet dhe të mos e ketë vendin e merituar sot në arenën e gjuhëve më të lashta botërore.

Në kreun hyrës janë formuluar mjaft qartë hapat e ndërmarra për realizimin me sukses të këtij punimi të doktoraturës.

Qysh në fillim të punimit jepet një arsyetim i duhur i temës:

Prejardhja e gjuhës shqipe i ka ngashëryer qysh në kohët më të hershme gjuhëtarët më me zë evropianë, sidomos ata gjermanë, të cilët kanë qenë të joshur nga leksiku, pastërtia, origjinaliteti dhe lashtësia e gjuhës sonë të bukur. Pavarësisht se përpjekjet për prejardhjen e gjuhës shqipe kanë qenë të kahershme, prapëseprapë ekziston një korpus jo i kënaqshëm shkencor lidhur me këtë problematikë. Mbase edhe situata e rëndë politike-shoqërore, ekonomike dhe pozita periferike gjeostrategjike, kanë ndikuar që studimet në fushën e prejardhjes së gjuhës shqipe të stagnojnë, ose të kamuflohet e vërteta lidhur me prejardhjen dhe vjetërsinë e gjuhës shqipe.

Gjuha shqipe është njëra ndër gjuhët më të vjetra të familjes Indoevropiane dhe ky është një fakt i pamohueshëm, megjithatë sllavët, të cilët me shekuj na e kanë mohuar gjuhën, kulturën, historinë dhe ekzistencën tonë, janë përpjekur me të gjitha mjetet që ta minimizojnë këtë fakt. E mira është se studiuesit e huaj, në veçanti ata gjermanë, dinë ta bëjnë ndarjen e shkencës me politikën dhe falë tyre ne sot kemi një gjuhë, e cila njihet si njëra ndër gjuhët më të vjetra të botës.

Përzgjedhja e një teme të tillë për hulumtim ka për synim të nxjerrë kontributin e shquar të studiuesve gjermanë për vënien e themeleve të gjuhës shqipe, siç e kemi sot. Në veçanti, do të hulumtohet dhe nxirret në pah kontributi i albanologëve të shquar gjermanë si: Lajbnici, Xyländer-i, Gustav Majeri, Norbert Jokli, Oda Bucholz-i, Fiedler-i, etj., të cilët i janë rrekur një pune të thelluar dhe frytdhënëse për prejardhjen, strukturën dhe veçantitë e gjuhës shqipe, duke e cilësuar atë si njëren ndër gjuhët më të lashta të Evropës, por edhe të studiuesve vendorë dhe rajonalë, të cilët kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin kontribut të çmuar në këtë drejtim.

Duke u bazuar në parametrat e sipërpërmendura, shtrohen këto pyetje hulumtuese, të cilave kjo tezë doktrature u përgjigjet:

- Përforcimi i tezës se gjuha shqipe është njëra ndër gjuhët më të vjetra të Ballkanit, por edhe të Evropës dhe se shqipja, ndonëse ka përkime me ilirishten e vjetër dhe trakishten, prejardhjen e ka nga vetë shqipja.
- Studiuesit gjermanë kanë luajtur një rol kyç në strukturimin shkencor të prejardhjes së gjuhës shqipe, por edhe në vënien e bazamentit të albanologjisë (Shkolla e Munihut, e Bonn-it dhe e Vjenës).
- Hedhja dritë mbi prejardhjen e gjuhës shqipe ndër lidhet ngushtë edhe me senzibilizimin mbarëkombëtar dhe vazhdimësinë e traditës gjuhësore, kulturore dhe historike të popullit shqiptar
- Rrethanat politike-shoqërore e imponojnë sot e gjithë ditën domosdoshmërinë e mbrojtjes institucionale të prejardhjes dhe qenies së gjuhës shqipe.

Edhe hipotezat e ngritura janë filluar me përpikëri shkencore, gjë që dëshmon për një qasje serioze hulumtuese-shkencore:

- Duke u bazuar në hulumtimet ekzistuese dhe në shpalosjen e dokumenteve të reja, do të postulohet teza se gjuha shqipe është njëra ndër gjuhët më të lashta të hapësirës ballkanike dhe asaj evropiane.
- Edhe pse nuk ekzistojnë të dhëna të mjaftueshme shkencore se gjuha shqipe prejardhjen e ka prej ilirishtes, në bazë të dokumenteve të siguruar arkivore, që
- kryekëput përmbajnë floskla të ilirishtes, të përfshira në masë të madhe sot në leksikun e shqipes, e përfaqësojmë me bindje të plotë tezën se gjuha shqipe prejardhjen e ka prej ilirishtes.
- Shumë huazime, të cilat supozohet të kenë hyrë sot në leksikun e shqipes, përmes latinishtes, rezultojnë të jenë me prejardhje nga ilirishtja.
- Duke qenë se gjuha shqipe prejardhjen e ka nga ilirishtja, ajo është edhe ushqyesja kryesore e leksikut të shumë gjuhëve indoevropiane si të gjuhëve romane dhe gjermanike.
- Të folmet e shumta të shqipes dëshmojnë për lashtësinë e saj, por edhe për përkimet me ilirishten e vjetër dhe trakishten.
- Marrja dhe dhënia janë premisa natyrore në ndërveprimin njerëzor dhe shoqëror, që projektohen edhe në korpusin gjuhësor dhe kulturor, kështu që shfaqja e një fjale në më shumë gjuhë të afërta gjenetikisht, nuk nënkupton se prejardhja e një gjuhe është e

diskutueshme. Për më tepër, leksiku i pasur i shqipes ka shërbyer si një ndërlidhëse për shumë gjuhë të rajonit.

- Në situatat e tanishme politike-shoqërore, nevojitet më shumë sensibilizim institucional për dëshminë e prejardhjes së gjuhës shqipe, ruajtjes dhe kultivimit të saj si dhe faktorizimit të saj rajonal dhe evropian.

Evident është edhe korpusi i dendur metodologjik, i cili konsiston në metodat e përdorura si në vijim:

- Metodot idiografike, të cilat luajnë një rol të veçantë të kuptimit nga brenda të shkaqeve të veprimit të aktorëve në kontekstin historik;
- Metodot diskursive, të cilat, nga njëra anë, mund të përdoren që të bëhet sa më transparent konstruksioni gjuhësor i politikave kombëtare, kurse nga ana tjetër analiza e diskursit e dekonstruktin realitetin gjuhësor tonin dhe e zhvesh nga realiteti i përkthyer, i imponuar si një e vërtetë absolute për dekada me radhë.
- Metodot normative, rolin e politikave globale gjuhësore nuk e sqarojnë drejtpërdrejt, megjithatë japin propozime konkrete dhe praktike për impaktin që kanë ato në arenën ndërkombëtare.
- Metodot deskriptive, kanë një rëndësi të veçantë për përshkrimin e mbarë procesit të zhvillimit gjuhësor dhe rolin e gjuhës së rrethanat e sotme.
- Metoda e vëzhgimit të drejtpërdrejtë, e cila do të jetë me rëndësi të veçantë në arritjen e rezultateve konkrete praktike.
- Metoda krahasuese, e cila për qëllim ka t'i krahasojnë analizat dhe rezultatet e ndryshme, që më në fund të mund të arrihet deri te njohuritë më solide të procesit të zhvillimit të gjuhës shqipe si në rrafshin diakronik edhe në atë sinkronik.
- Metoda e intervistës, e cila përmes intervistimit të personaliteteve pjesëmarrëse në formësimin e politikave gjuhësore mbarëkombëtare, qoftë vendore, rajonale apo të huaja, ndikon dukshëm në arritjen e rezultateve konkrete të hulumtimit.

Kandidatja ka konsultuar dhe cituar rajone relevante vendorë, rajone dhe gjermanë, si Eqrem Çabej, Shezai Rrokaj, Shaban Demiraj, Emil Lafë, Berton Sulejmani, Arbër Çeliku, Koleç Topalli, Wilhelm Fiedler, Gustav Majer, Norbert Jokli, Robert Elsi, Armin Hetcer, Oda Buholc, etj., por edhe punimet e konferencave të përmbledhura nga Akademia e Shkencave të

Kosovës lidhur me etnogjenezën e gjuhës shqipe, të Institutit Albanologjik të Prishtinës, ka cituar edhe dokumente arkivore, si dhe ka realizuar 3 intervista të autorëve, që merren me tashmë gjatë kohë me këtë problematikë si Shezai Rrokaj, Ajtene Hajdari-Qamili dhe Joachim Matzinger, bashkëpunëtor i Akademisë së Shkencave Austriake, që tashmë po punon në fillimin e autoktonisë së plotë të shqipes në kuadër të Akademisë së Shkencave Austriake.

Punimi është i struktura në këtë mënyrë:

Ai ka gjatë kapituj, përfundimin dhe shtojcën, në të cilën janë rimarrë tri intervista, që ndërlidhen me punimin në fjalë.

Në **kreun hyrës** jepen qëllimet e punimet, përvijohet korniza teorike dhe korpusi, si dhe sqarohet metodologjia e punës.

Me kreun 2 fillojnë edhe krerët tematikë të punimit. Në kreun 2 jepen të dhëna historike mbi shqipen, mbi strukturën e saj fonetike, morfologjike, sintaksore dhe leksikore, si dhe një nënkapitull tregon veçantitë e shqipes në raport me gjuhën gjermane. Këto veçanti janë në kohët e foljes, në mënyrat e foljes, në diatezat, në përdorimin e përemrave, në fjalëformim, rendin e fjalëve në fjali, etj.

Kreu 3 trajton historikun e shkrimit shqip nga fillesat e deri më sot, kontributin e gjuhëtarëve nëpër periudhat e ndryshme të historisë si iluministët, rilindasit, realistët, etj., sfidat me të cilat janë përballur ata nën sundimet e ndryshme, dhe kështu me radhë. Një vend i veçantë në këtë kapitull i kushtohet edhe kongresit të Manastirit, komisivë të ndryshme letrare si asaj të Elbasanit dhe Shkodrës, si dhe historikut të standardit të gjuhës shqipe, konkretisht Kongresit të drejtshkrimit në vitin 1972 në Tiranë.

Kreu 4 ka të bëjë kryesisht me etnogjenezën e shqipes në këndvështrimin e albanologëve gjermanë nga fillesat e deri më sot. Në këtë kapitull paraqitet një korpus i gjerë teorik mbi veprimtarinë e studiuesve gjermanë në rrafshin diakronik, të cilët kryesisht kanë hartuar fjalorët e parë etimologjikë të shqipes, por kanë hulumtuar dhe gramatikën dhe thesarin e gjuhës shqipe.

Kreu 5 paraqet një tablo të albanologëve gjermanë dhe shqiptarë, që publikojnë në gjuhën gjermane për albanologjinë, fillon kontributin e tyre për etnogjenezën e shqipes, historikun e saj, kultivimin dhe promovimin e gjuhës shqipe në nivel ndërkombëtar. Në këtë kapitull janë përfshirë albanologët e të tri plejadave: të gjuhësisë krahasuese, të shekull 18 dhe 19 dhe albanologët e kohës moderne.

Kreu 6 trajton albanologjinë gjermane si dhe gjendjen e albanologjisë sot, sfidat dhe perspektivat e saj në të ardhmen, sidomos duke marrë parasysh epokën gërryese të globalizmit dhe zhvillimin e hovshëm të inteligjencës artificiale.

Përfundim:

Duke marrë parasysh të gjithë këto parametra, ne, në cilësinë e komisionit vlerësues, konstatojmë se punimi i doktoraturës me temë: *Prejardhja e gjuhës shqipe në këndvështrimin e studiuesve gjermanë*, i kandidatës, znj. Jetmire Aliu i plotëson të gjitha kriteret e duhura hulumtuese-shkencore.

Rezultatet e arritura janë të kënaqshme dhe sjellin risi të dukshme në korpusin e tërësishëm shkencor lidhur me etnogjenezën e gjuhës shqipe dhe punimi i pasuron shkencat albanologjike me një punë serioze për një çështje po aq serioze, siç është autoktonia dhe etnogjeneza e gjuhës shqipe.

Prandaj dhe njëzëri japim **vlerësimin tonë pozitiv** lidhur me punimin e doktoraturës në fjalë.

PROPOZIM

Në cilësinë e anëtarëve të komisionit, ne e falënderojmë Këshillim mësimit-shkencor të Fakultetit filologjik për besimin e dhënë për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës të kandidatës Jetmire Aliu me temë: *Prejardhja e gjuhës shqipe në këndvështrimin e studiuesve gjermanë* dhe njëzëri i propozojmë Këshillit mësimit-shkencor respektiv, që ta miratojë vlerësimin tonë pozitiv lidhur me këtë punim doktore dhe të vazhdojë me procedurën e mëtejshme deri në mbrojtjen publike të këtij punimi të doktoraturës.

Tetovë, më 01.02.2024

Komisioni vlerësues


1. Prof. Dr. Berton Sulejmani – kryetar



2. Prof. Dr. Ajtene Hajdari-Qamili – anëtar



3. Prof. Dr. Arbër Celiku – anëtar



4. Prof. Dr. Gjuliano Iseini - anëtar



5. Prof. Dr. Shadan Ramadani – anëtar

